

UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1

Matura Shtetërore 2019

1. **Formulari A1** plotësohet online. Procedura e plotësimit do të bëhet sipas një udhëzimi të veçantë.
2. **Formularin A1** e plotësojnë vetëm maturantët/maturantet e vitit shkollor 2018 - 2019.
3. Plotësimi i **Formularit A1** fillon në Portalin Qeveritar e-albania, dhe përfundon në shkollë në portalin e Maturës.
4. Procesi i plotësimit të **Formularit A1** në shkollë ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtoria e shkollës, që quhet "mbikëqyrës".
5. Mbikëqyrësi pajiset me kodin përkatës të hyrjes në sistem. Vetëm pasi mbikëqyrësi vendos kodin mbikëqyrësit në sistem, maturanti/maturantja mund të përfundojë plotësimin e **Formularit A1** në shkollë.
6. Formulari i plotësuar printohet, nënshkruhet nga maturanti/maturantja dhe mbikëqyrësi si dhe vulozet nga drejtori i shkollës ku plotësohen formularët A1. Shkolla ruan një kopje të formularëve të printuar deri në përfundim të Maturës Shtetërore 2019.

I. TË DHËNA PERSONALE

Plotësohen nga maturanti/maturantja.

- **Tek pika 1 e formularit A1**, (numri personal i letërnjoftimit ID), maturanti/maturantja shënon numrin e tij/saj personal që ka në dokumentin e identifikimit. Ky informacion është i detyrueshëm dhe pa plotësuar atë, nuk mund të vijohet me aplikimin.

Për të dhënat në pikat **2-5 të formularit A1**, pasi maturanti/maturantja bën plotësimin, sistemi bën verifikimin e tyre dhe nuk lejon të vazhdohet aplikimi, nëse ka pasaktësi.

- **Tek pika 6 e formularit A1**, maturanti/maturantja shënon në fushat përkatëse adresën e email-it dhe numrin e telefonit të cilat duhet të ruhen të pandryshuara deri në fund të Maturës Shtetërore 2019, me qëllim që ai/ajo (maturanti/maturantja) të marrë informacion në fazën e ndryshme të procesit. Nëse maturanti/maturantja nuk ka telefon, ose nuk dëshiron të shënojë numrin e telefonit, atëherë mbikëqyrësi shënon numrin e tij të telefonit.
- **Tek pika 7 e formularit A1**, shënohet X tek kutizat pranë Po ose Jo.

II. TË DHËNA SHKOLLORE

Të dhënat shkollore do të plotësohen në bashkëpunim me **mbikëqyrësin** e sallës ku bëhet aplikimi. Për plotësimin saktë të kërkesave të këtij grupimi, maturanti/maturantja dhe mbikëqyrësi duhet të marrin informacion të saktë dhe të plotë për secilën nga rubrikat përkatëse:

Plotësohen nga maturanti/maturantja.

- **Tek pika 8 e formularit A1;** (emri i qytetit/fshatit), maturanti/maturantja shënon emrin e qytetit/fshatit ku ndodhet shkolla ku po ndjek studimet.
- **Tek pika 9 e formularit A1;** (emri i shkollës ku studion), maturanti/maturantja shënon emrin e shkollës ku po studion.

Plotësohen nga mbikëqyrësi.

- **Tek pika 10 e formularit A1,** mbikëqyrësi plotëson emrin e DAR/Za-së përkatëse.
- **Tek pika 11 e formularit A1,** (indeksi i profililit), mbikëqyrësi zgjedh nga lista numrin dyshifror që i përket emërimit të profililit të shkollës ku ndjek studimet maturanti/maturantja, sipas listës së miratuar nga MASR.
- **Tek pika 12 e formularit A1,** (emërtimi i profililit) mbikëqyrësi plotëson emrin e profililit/degës.
- **Tek pika 13 e formularit A1,** mbikëqyrësi plotëson klasën dhe paralelin e klasës ku po studion maturanti/maturantja.
- **Tek pika 14 e formularit A1,** zgjidhet nga lista, gjuha e huaj që në planin mësimor të shkollës trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar.

III. TË DHËNA LËNDORE

Plotësohen nga maturanti/maturantja.

- **Tek pika 15 e formularit A1,**
- Numri i lëndëve që do të zgjidhen nga maturanti/maturantja e gjimnazit dhe shkollës së mesme artistike do të jetë 1 (një). Maturanti/maturantja zgjedh nga lista lëndëve me zgjedhje Z, lëndën që dëshiron të japë provim respektivisht në bllokun I dhe II.
- Zgjedhja e lëndës për maturantët e gjimnazeve dhe shkollave të mesme artistike bëhet në përputhje me Udhëzimin Nr. 3, datë 14.02.2018, "Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të MSH 2019", i ndryshuar dhe zgjedhja e drejtimit/profililit të Teorisë Profesionale të integruar për maturantë e shkollave profesionale, bëhet në përputhje me Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2019".
- Teoria profesionale e integruar është e zbërthyer në drejtime/profile sipas indeksit të shkollave.
- Maturanti/maturantja e shkollave profesionale zgjedhjen e provimit të detyruar të teorisë profesionale të integruar duhet ta bëjë detyrimisht në grupin III, "Për shkollat e mesme profesionale".

